

# Relacion

## Mbi hartimin e raporteve te monitorimit

### 1.Lista e përmbajtjes së raportit të monitorimit të buxhetit

- Hyrje
- Informacion buxhtor i agreguar
- Performanca e treguesve kyç të performancës në bazë gjinore, nivel produkti
- Performanca e buxhetit në nivel programi
- Projektet kapitale
- Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit)
- Përfundime, ndryshime në buxhet

### 2.Hyrje

Programi “Menaxhimi i të Ardhurave Doganore” është pjesë e grupit 10 Ministria e Financave dhe përbëhet nga 19 njësi ekonomike (Aparati + 18 Degë Doganore). Buxheti i akorduar programit është bazuar në Deklaratën e Politikës së Programit të hartuar gjatë procesit të PBA-së 2025-2027. Politika buxhetore e programit është fokusuar në përmbushjen në kohë të objektivave dhe detyrimeve ligjore si dhe të angazhimeve të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare në proceset e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Monitorimi i zbatimit të buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor 2025 për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar për të siguruar realizimin e qëllimit dhe objektivave të synuara të Institucionit. Nëpërmjet këtyre raporteve të monitorimit evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të miratuara në nivel kapitulli si dhe artikulli buxhetor si dhe treguesve të performancës dhe produkteve të parashikuara për tu realizuar. Realizimi i shpenzimeve të buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor 2025, paraqitet si më poshtë vijon:

në 000 lekë

Titulli	Emri i Programit	Buxheti fillestar 2025	Buxheti rishikuar 2025	Fakti Janar-Dhjetor 2025	Realizimi kundrejt planit mujor %
01150	Menaxhimi i të ardhurave Doganore	4,639,993	3,994,808	3,835,825	96

### 3. Informacion buxhetor i agreguar

Buxheti i fillestar i miratuar me anë të ligjit nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025” i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, programi buxhetor “Menaxhimi i të ardhurave doganore”, është 4,639,993 mijë lekë ndarë sipas zërave buxhetor; Shpenzime korrente 4,310,773 mijë lekë dhe shpenzime kapitale 329,220 mijë lekë. Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2025 ky plan ka pësuar ndryshimet si më poshtë:

1. Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 2244/1 datë 06.02.2025, është alokuar fondi i veçantë me vlerë 2,350 mijë lekë.
2. Me shkresën e Ministrisë së Financave nr.8627/3 prot, datë 18.06.2025 është miratuar rialokim fondi për shpenzimet korrente midis njësive ekonomike të institucionit tonë pa ndyshuar totalin e këtij artikulli për programin buxhetor.
3. Me anë të aktit normativ nr.6, datë 11.06.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar , për programin tonë janë pakësuar fondet e shpenzimeve korrente produkti 91005AE “Shërbim i skanimit” në shumën 49,192 mijë lekë dhe shpenzimet kapitale projekti “Përmirësimi i infrastrukturës hardëare për sistemet doganore dhe rrjetet fizike” në shumën 220.000 mijë lekë Për produktin 91005 AA shuma e pakësuar është rezultat i uljes se kursit të këmbimit ndërsa shuma e fondit buxhetor për projektin 24AG401i kaloj AKSHI-it me qëllim rritjen e efijensës dhe përshpejtimin të zbatimit të tij.
4. Me shkresën e Ministrisë së Financave nr.9072/3 prot, datë 18.07.2025, është akorduar shtesë fondi i veçantë me vlerë 3,000 mijë lekë.
5. Me anë të shkresës së Ministrisë së Financave nr. 14323/1prot, datë 13.10.2025 është miratuar rialokim fondi për shpenzimet korrente midis njësive ekonomike të programit tonë.
6. Nisur nga ecuria e realizimit të buxhetit, me anë të aktit normativ nr.10 datë 08.10.2025, janë pakësuar fondet e shpenzimeve korrente në shumën 161,350 mijë lekë në produktin 91005 AA “Deklarata doganore të procesuara” shuma 103,480 mijë lekë ,dhe në produktin 91005AE “Shërbim i skanimit” shuma 57,870 mijë lekë.
7. Me shkresën e Ministrisë së Financave nr.15363/1prot, datë 06.11.2025 është miratuar rialokim fondi për shpenzimet operative midis produkteve të Aparatit të Drejtorisë, pa ndyshuar totalin e këtij artikulli për programin buxhetor.
8. Me shkresën e Ministrisë së Financave nr.16039/1 prot, datë 11.11.2025 është miratuar rialokim fondi për shpenzimet e personelit midis njësive ekonomike të institucionit tonë pa ndyshuar totalin e këtij artikulli për programin buxhetor.
9. Me shkresën e Ministrisë së Financave nr.16391/2 prot, datë 03.12.2025, është pakësuar fondi i veçantë me vlerë 2,000 mijë lekë.
10. Me anë të aktit normativ nr.11, datë 19.12.2025 janë pakësuar fondet e shpenzimeve korrente në shumën 217,744 mijë lekë, shpenzimet kapitale me financim të brendshëm në shumën 23,249 mijë lekë, si dhe janë shtuar fondet e financimit të huaj në shumën 23,000 mijë lekë, shumë kjo e pakërkuar nga ana e programit tonë .

Në mënyrë të përmbledhur buxheti i akorduar, rishikuar dhe realizuar për programin 01150 “Menaxhimi i të ardhurave doganore” për periudhën Janar-Dhjetor 2025 sipas artikujve buxhetor në 000/lekë, është si më poshtë:

Art	Emërtimi	Fakti i vitit paraardhës 2024	Plan fillestar viti 2025	Akordim F.Vecantë	Transfart buxhet	Akti norm nr 6 dt 11.06.2025	Akti norm nr.10 dt 08.10.2025	Akti norm nr 11 date 19.12.2025	Plan i ris hikuar 2025	Realizuar 2025	Diferenca
600	Paga	1,354,454	1,483,830	-	18,034	-	-30,875	-14,850	1,456,139	1,446,832	9,307
601	Sigurime Shoqërore	222,861	242,953	-	10,19	-	-2,122	-3,920	237,930	235,737	2,193
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	2,100,173	2,573,634	-	-19,053	-49,192	-128,353	-198,974	2,178,062	2,080,564	97,498
605	Transferta Korente të Huaja	5,999	10,356	-	-	-	-	-	10,356	9,981	375
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	7,678	-	3,350	-	-	-	-	3,350	3,010	340
<b>I</b>	<b>Shpenzime korrente</b>	<b>3,691,165</b>	<b>4,310,773</b>	<b>3,350</b>	<b>0</b>	<b>-49,192</b>	<b>-161,350</b>	<b>-217,744</b>	<b>3,885,837</b>	<b>3,776,124</b>	<b>109,713</b>
231	Kapitale të Trupëzuara	30,464	323,220	-	-	-220,000	-	-23,249	79,971	58,691	21,280
	<b>Shp kapitale FB</b>	30,464	323,220	0	-	-220,000	-	-23,249	79,971	58,691	21,280
230	Kapitale të Patrupëzuara	4	6,000	-	-	-	-	20,000	26,000	1009	24,991
231	Kapitale të Trupëzuara	-	-	-	-	-	-	3,000	3,000	0	0
	<b>Shp kapitale me FH</b>	4	6,000	-	-	-	-	23,000	29,000	1009	27,991
<b>II</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>30,468</b>	<b>329,220</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-220,000</b>	<b>-</b>	<b>-249</b>	<b>108,971</b>	<b>59,700</b>	<b>49,271</b>
<b>III</b>	<b>Shp nga të ardhurat jashtë limitit</b>	<b>201,245</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>0</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>190,070</b>	<b>171,465</b>	<b>18,605</b>
<b>To tali (ko rrente + kapitale)</b>		<b>3,922,878</b>	<b>4,639,993</b>	<b>3,350</b>	<b>0</b>	<b>-269,192</b>	<b>-161,350</b>	<b>-217,993</b>	<b>4,184,878</b>	<b>4,007,289</b>	<b>177,589</b>

#### 4. Performanca e treguesve kyç të performancës në bazë gjinore, nivel produkti.

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2025 numri faktik i punonjëve të administratës doganore ka qënë 984 nga të cilët femra 299 punonjëse. Numri i punonjëve të miratuar për administratën doganore është 1074 punonjës, për këtë periudhë ka patur 90 vakanca.

#### 5. Performanca e buxhetit në nivel programi

Qëllimi i Politikës së programit është: “Menaxhimi efektiv, efikas, i drejtë dhe transparent i të ardhurave doganore”. Treguesi i performancës është: Mbledhja faktike e të ardhurave krahasuar me parashikimet. Për vitin 2025 ky tregues performance u realizua në masën 98.2%. Vazhdon mbivlerësimi i monedhës lekë i cili ka një ndikim të konsiderueshëm në realizimin e planit të të ardhurave për administratën doganore, fenomen ky jashtë kontrollit të administratës sonë. Për vitin 2025 krahasuar me vitin e kaluar u realizuan të ardhurat në mld lekë:

Muaji	Realizim 2024	Realizim 2025	Plan 2025	% 2025-2024	Diferenca 2025-2024	Realizimi 2025 Realizimi 2024, %
Janar	15,058	16,385	16,383	108.8	1,326	8.80%
Shkurt	16,933	17,259	17,259	101.9	325	1.90%
Mars	18,105	19,166	19,157	105.9	1,061	5.90%
Prill	18,895	19,631	19,628	103.9	735	3.90%
Maj	20,776	20,228	20,228	97.4	-548	-2.60%
Qershor	20,240	20,994	20,993	103.7	753	3.70%
Korrik	21,320	23,257	23,252	109.1	1,937	9.10%
Gusht	21,421	21,144	21,145	98.7	-276	-1.30%
Shtator	18,486	20,628	20,626	111.6	2,141	11.60%
Tetor	19,232	21,018	21,449	109.3	1,786	9.30%
Nentor	18,577	18,483	20,750	99.5	-94	-0.50%
Dhjetor	20,562	21,515	23,179	104.6	952	4.60%
<b>Progresive</b>	<b>229,608</b>	<b>239,708</b>	<b>244,049</b>	<b>104.4</b>	<b>10,100</b>	<b>4.40%</b>

Objektivat kryesore të programit janë:

- Krijimi i lehtësirave për operatorët ekonomik nëpërmjet lehtësimit dhe përsheptimit të procedurave doganore.
- Garantimi i sigurisë dhe i mbrojtjes kombëtare nga: kontrabanda, trafiqet paligjshme, mallrat e ndaluara e fallsifikuara, evazioni fiskal etj

Gjatë viteve të fundit, administrata doganore është udhëhequr nga parimi i transparencës dhe përgjegjshmërisë në raport me bizneset dhe qytetarët, në funksion të objektivave të saj, jo vetëm për mbledhjen e të ardhurave, por sidomos lehtësimin e procedurave dhe mbrojtjen e tregtisë së ligjshme dhe të ndershme. Informatizimi i procedurave dhe formaliteteve doganore, aplikimet online, veçanërisht përgjatë dy viteve të fundit, kanë lehtësuar aktivitetin prodhues, importues dhe (ri)eksportues të bizneseve dhe për periudhën në vijim synohet lehtësimi i mëtejshëm i procedurave doganore.

ADSH ka fuqizuar më tej aktivitetet dhe veprimet që kontribuojnë në sigurinë dhe mbrojtjen e shoqërisë, ruajtjen në të mirë të shëndetit të qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit. Një rëndësi e veçantë i luftës kundër pastrimit të parave, shkeljeve ndaj IPR si dhe Materialeve të ndaluara si drogave si dhe mallrat radioaktive.

Gjatë kësaj periudhe janë ushtruar kontrolle në të gjithë territorin doganor, akset rrugore, si dhe në porte dhe hapësirat tona detare, ku përparësi kanë patur ngarkesat me mallra me risk, duke shfrytëzuar informacionet nga terreni, si dhe ato në dispozicion, sipas llojit të mallit, subjektit, klasifikimit tarifor, origjinës, por edhe kontrollet për trafiqe të paligjshme janë realizuar gjithsej 8994 inspektime doganore. Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025, nga Drejtoria e Antikontrabandës (Sektori Tokësor & Detar), janë realizuar 3093 kontrolle nga të cilat 886 ose rreth 29% kanë qenë të plota. Gjatë kontrolleve të ushtruara, janë zbuluar 120 raste me shkelje doganore, nga të cilat 74 raste me penaltet me një vlerë totale 11,332,568 lekë. Efektiviteti i kontrolleve me shkelje për periudhën Janar - Dhjetor 2025, rezulton në masën 8.35%.

Kontrollet, janë ushtruar në të gjithë territorin doganor, akset rrugore, si dhe në porte dhe hapësirat tona detare, ku përparësi kanë patur ngarkesat me mallra me risk, duke shfrytëzuar informacionet nga terreni, si dhe ato në dispozicion, sipas llojit të mallit, subjektit, klasifikimit tarifor, origjinës, por edhe kontrollet për trafiqe të paligjshme

Nga Drejtoria Antitrafik janë ushtruar 5,901 kontrolle dhe monitorime në Pikat e Kalimit Kufitar në Degët Doganore Durrës, Rinas, Qafë Thanë, Hani i Hotit, Vlore, Kakavije, Kapshtice Muriqan dhe Morinë ndaj individëve/udhëtarëve, automjeteve, mjeteve të transportit të udhëtarëve dhe mallrave.

Drejtoria e Hetimit, nisur nga informacione të strukturave të tjera të DPD-së, apo për çështje të nisura kryesisht pas mbledhjes së të dhënave si dhe kryerjes se veprimeve paraprake, mbi bazën e dyshimeve të arsyeshme për kryerjen e veprave penale të parashikuara në legjislacionin penal në fushën e doganave për shmangie të detyrimeve doganore apo detyrimeve të akcizës sipas përcaktimeve të nenit 277 të ligjit nr. 102 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar ka përgatitur dhe ka dërguar pranë Organit të Prokurorisë gjatë kësaj periudhe gjithsej 21 referime, janë konstatuar 1 shkelje doganore kundravajtje administrative, 23 shkelje doganore kontrabandë, janë

dërguar Degëve Doganore 25 informacione për marrje vendimi. Gjatë periudhës Janar - Gusht 2025 kanë qenë në proces hetimi çështje me karakter sensitiv apo kërkesa për verifikim nga të cilat, janë trajtuar 3574 çështje dhe mbyllur 2568 çështje.

Realizimi i treguesve të performancës:

Treguesit e Performancës	viti 2024	viti 2025
Koha e procesimit të deklaratave doganore në kanal të verdhë	60'	74'
Koha e procesimit të deklaratave doganore në kanalin e kuq	438'	496'
Koha e procesimit të deklaratave doganore në kanalin jeshil	36'	51'
Numri i deklaratave doganore të procesuara në kanalin jeshil (në import)	155,064	175,903
Numri i deklaratave doganore të procesuara në kanalin jeshil (në export)	69,681	75,642
Numri i Operatorëve Ekonomik të Autorizuar (AEO)	16	18
Numri i grave qe punojne ne sistemin doganor	290	299
Numri i burrave qe punojne ne sistemin doganor	784	775

Koha e procesimit të deklaratave doganore është një ndër elementet më të rëndësishëm të performancës, të matshëm nga Organizata Botërore e Doganave. Kemi nje rritje të kohës së përpunimit të deklaratave në të gjitha kanalet e riskut, që vjen përgjithësisht nga problematikat e kapaciteteve përpunuese të sistemit informatik.

Në periudhën Janar-Dhjetor 2025 janë përpunuar 758,955 deklarata doganore është numri më i lartë i deklaratave të përpunuara nga administrata doganore, ku rritjen më të madhe e ofrojnë deklarata e importit 4, të cilat janë edhe deklarata që sjellin të ardhurat për administratën doganore, duke treguar edhe rritjen e numrit të deklarimeve në doganë.

Numri i Operatorëve Ekonomik të Autorizuar (AEO). Çertifikata “Operatori Ekonomik i Autorizuar”, është një status i lëshuar për “tregtarët me besueshmëri” të cilët mund të përfitojnë nga shumë thjeshtime doganore në kuadër të Marrëveshjes së Tregtisë mes vendeve të Ballkanit Perëndimor-CEFTA. Deri ne fund të vitit 2024 me këtë status kryenini veprimtarinë 16 operatorë ekonomik. Gjatë vitit 2025 e kanë pëfituar këtë status edhe 2 operatorë ekonomik duke e çuar numrin e tyre në 18.

Plani fillestar, plani i rishikuar si dhe realizimi i artikujve buxhetor për periudhën Janar-Dhjetor 2025 paraqitet si më poshtë:

Art	Emërtimi	Plan fillestar Viti 2025	Plan rishikuar vjetor	Realizuar Janar-Dhjetor 2025	% e realizimit ndaj planit të rishikuar
600	Paga	1,483,830	1,456,139	1,446,832	99%
601	Sigurime Shoqërore	242,953	237,930	235,737	99%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	2,573,634	2,178,062	2,080,564	96%
605	Transferta Korente të Huaja	10,356	10,356	9,981	96%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	-	3,350	3,010	90%
231	Financim i brendshëm	323,220	79,971	58,691	73%
230	Financim i Huaj	6,000	29,000	1,009	3%
	Shuma	4,639,993	3,994,808	3,835,834	96%

Realizimi i buxhetit të programit për periudhën Janar-Dhjetor 2025 është 96% e planit të rishikuar.

U parashikuan me fondet e miratuara të shpenzimeve korrente produktet e mëposhtme, realizimi i të cilave krahasuar me planin paraqitet si vijon:

në 000/ lekë

Kodi produktit	Produkti	Plani fillestar	Plani rishikuar	shuma e realizuar	Sasia e realizuar
91005AA	Deklarata doganore të procesuara	2,469,115	2,186,465	2,116,755	758,955
91005AB	Vendime gjyqësore të ekzekutura	20,000	31,279	31,277	24
91005AC	Inspektime doganore të kryera	233,960	212,681	175,377	8,994
91005AD	Hetime doganore të kryera	14,000	14,000	11,140	2,568
91005AE	Shërbim i skanimit	1,573,698	1,441,412	1,441,412	5
	Shuma	4,310,773	3,885,837	3,775,961	

## 6. Projektet Kapitale

Shpenzimet Kapitale me financim të brendshëm (art 230-231). Për vitin 2025 me anë të ligjit nr. nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr.3853/3 datë 18.03.2025 “Dërgohet miratimi i detajimit të shpenzimeve kapitale për vitet 2025-2027” u planifikuan për tu realizuar investimeve në shumën 329,220 mijë lekë nga të cilat më financim të brendshëm 323,220 mijë lekë dhe me financim të huaj 6,000 mijë lekë.

Me anë të aktit normativ nr. 6, datë 11.06.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, u pakësuan dhe transferuan pranë Akshi-it fondet e shpenzimeve kapitale të miratuara për projektin “Përmirësimi i infrastrukturës hardëare për sistemet doganore dhe rrjetet fizike” në shumën prej 220.000 mijë lekë per 2025 dhe 122.000 të planifikuara për vitin 2026.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025 nga shpenzimet e parashikuara per shpenzimet kapitale u realizuan produktet:

000/lekë

Kodi projektit	Emërtesa e investimeve	Plani fillestar	Plani rishikuar	shuma e realizuar	Sasia e realizuar
24AG401	Përmirësimi i infrastrukturës hardëare për sistemet doganore dhe rrjetet fizike	220,000	0	0	0
18AW108	Skaner per kontroll bagazhesh	28,700	28,700	28,680	4
18AW103	Blerje pajisje teknike për Laboratorin Doganor	39,470	20,602	0	0
25AA001	Rikonstruksion i çatisë së godinave ku ushtrojnë veprimtarinë administrata doganore dhe Agjensitë Doganore ne Kapshtice	14,340	10,201	10,197	2
M100002	Blerje pajisje zyre	610	368	368	15
18AW109	Blerje motorgjenerator	4,100	4,100	4,038	1
M100216	Blerje minibus per transport personeli	16,000	16,000	15,408	2
19AD102	Projekti PEN-CP në kuadër të Programit Horizon 2020.	2,110	2,110	218	1
25AA101	Programi "Doganat"	3,280	3,280	791	1
M100024	Financim për projekte të huaja	610	610	0	0
20AD301	IPA 2017 disbursim i Fondit Kombëtar	0	20,000	0	0
GM10102	Pjesmarje në programin "Doganat 2020"	0	3,000	0	0
	<b>Shuma</b>	<b>329,220</b>	<b>108,971</b>	<b>59,700</b>	

## 7. Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit

Krahas fondeve të akorduara nga buxheti i shtetit gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025 janë realizuar shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit si më poshtë:

në 000/lekë			
Nr	Emërtimi	Fond i krijuar	Fond i realizuar
1	Shpenzime personeli (600+601)	70,647	66,296
2	Shpenzime të tjera korente (602)	11,173	2,849
3	Shpenzime kapitale (231)	11,360	5,521
4	Transferta korrente të brendshme (art 604)	96,890	96,799
	TOTALI	190,070	171,465

Në shpenzimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nga të ardhurat jashtë limitit përfshihen:

-Fondet e krijuara nga vendosja e sanksioneve doganore në zbatim të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.919, datë 29.12.2014 “Për miratimin e dispozitave zbatuese të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 285,

-Të ardhurat nga pagesat e kryera nga deklaruesit për shërbimin e kryerjes së analizave laboratorike për verifikime doganore, në zbatim të marrëveshjes së asistencës ndërmjet Agjencisë së Doganave Italiane, dhe Strukturës Përgjegjëse për Doganat Shqiptare në fushën e laboratorëve kimikë doganorë si dhe nga operatorët ekonomikë në ambjentet e të cilëve ka prezencë të personelit doganor.

-Gjithashtu, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025 janë kryer transferta prej 96,799 mijë lekë njësi vendore për rentën minerare të shfytëzuar në teritorin e tyre (art 604) , në bazë të autorizimeve të lëshuara nga Ministria e Financave në zbatim të Ligjit nr.157/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.07.2008 ‘Për taksat kombëtare, të ndryshuar’, si dhe në zbatim të Udhëzimit nr.12 datë 04.04.2017 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare’, të ndryshuar.

## 8. Përfundime, ndryshime në buxhet

Programi “Menaxhimi i të ardhurave doganore” e ka realizuar buxhetin e miratur për vitin 2025 në masën 96%. Për vitin 2026 prioritetet kryesore të Administratës Doganore do të jenë: Eficencë, Siguri dhe Prosperitet për të përmirësuar të gjitha shërbimet doganore. Në mënyrë të veçantë, fokusi ka qenë dhe mbetet te përafrimi i shërbimit doganor shqiptar me standardet e një dogane evropiane, në aspektin ligjor, institucional, profesional dhe teknologjik